

KONTRAKTIM EKSPERTI PËR AFTËSINË E KUFIZUAR

Caritas Shqiptar, në kuadër të zbatimit të projektit **INCLUSION** “*Instalim, Rrjetëzim dhe Ngritje Kapacitetesh përmes Këshillimit Ligjor dhe Ndërhyrjeve Strategjike të Unifikuara lidhur me Nevojat e Personave me Aftësi të Kufizuar, Shqipëri*” me kod 1720009, kërkon të zhvillojë 3 Tryeza të Rrumbullakëta me temë: “**Ligji i ri për nxitjen e punësimit**”, në tre zonat e zbatimit të projektit: Vau Dejës, Lezhë dhe Kurbin.

Eksperti është një person i cili është i kualifikuar dhe profesionist në fushën e Aftësisë së Kufizuar, i cili duhet të moderojë Tryezat e Rrumbullakëta, duke dhënë informacion lidhur me legjislacionin në fuqi *Nr.15/2019*, mbi temën e përcaktuar “**Ligji i ri për nxitjen e punësimit**”.

Qëllimi i zhvillimit të Tryezave të Rrumbullakëta është shpërndarja e informacionit dhe bashkëpunimi me aktorët kryesore të projektit, siç janë institucionet publike/private apo kompani/biznese të ndryshme. Fokusi i gjithë takimeve janë përfshirja e personave me aftësi të kufizuar në punësim dhe njohja me fasilitetet që ofron ligji i ri i nxitjes së punësimit.

Detyrat:

- Eskperti duhet të kryejë ciklin prej 3 Tryezash të Rrumbullakëta në nivelin më të lartë të kompetencës dhe profesionalizmit;
- Afati i kryerjes së Tryezave të Rrumbullakëta është 10.02.2020-10-03-2020;
- Eskperti duhet të jetë i disponueshëm të zhvillojë aktivitetet në tre zonat e lartpërmendura.

Kualifikime dhe eksperiencia:

- Të ketë arsimin përkatës dhe kualifikime pasuniversitare të çertifikuara;
- Të ketë përvojë profesionale në fushën e Legjislacionit mbi Aftësinë e Kufizuar;
- Eksperiencia me organizata përbën avantazh në kryerjen e shërbimit;
- Të respektojë afatet e kërkuara dhe të demostrojë korrektësi në kryerjen e shërbimit.

Pagesa për shërbimin e kërkuar: Modalitetet për pagesën do të përcaktohen në kontratën e shërbimit.

Sa më sipër, ftohen Ekspertë me kualifikim dhe eksperiencën e duhur, të dërgojnë CV dhe letrën e interesit në adresën zyrtare të Caritas Shqiptar, caritasalbania@caritasalbania.org brenda datës 31 Janar 2020, ora 16:00.